

botëror. Këto armë janë më të forta e bëjnë shumë më tepër efekt nga ç'bëjnë raketat dhe mirazhet. Këtu qëndron arsyeja e dashurisë dhe e respektit të madh që kanë popujt e botës për Shqipërinë. Në vendet arabe, si në të gjitha vendet e tjera të globit tonë, e kanë në gojë Shqipërinë për qëndrimin e saj të drejtë e parimor ndaj ngjarjeve ndërkombëtare.

Unë dhe shokët e mi të pranishëm, Hysniu e Ramizi, ju falënderojmë shumë për vizitën që na bëtë ju, shokë të dashur të luftës, oficerë të ushtrisë sonë të lavdishme. Këtu midis jush ka edhe veteranë, që kanë dalë në pension, por të tërë ne jemi një, se nga lufta kemi dalë. U transmetoni të gjithë shokëve, ushtarë, oficerë, nënoficerë dhe veteranë të Ushtrisë sonë Popullore, përshëndetjet tona më të zjarrta, urimet më të mira të Partisë dhe të Komitetit të saj Qendror.

Ju ftoj ta ngremë një doli për Partinë tonë të lavdishme dhe për ushtrinë tonë trime!

Të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas skënimëve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## PA GRA REVOLUCIONARE NUK MUND TË KETË SOCIALIZËM

*Nga biseda me një grup grash*

16 tetor 1973

Faleminderit shumë që erdhët për vizitë, qofshi të lumtura e të gëzuara! Kështu do Partia, që populli të jetë i lumtur dhe i gëzuar gjithmonë.

Ditët e jetës sonë ia kushtojmë Partisë; puna jonë, vazhdimisht, orë e çast, do të jetë në shërbim të popullit. Detyra kryesore e njeriut tonë nuk është që të jetojë kot së koti, por të jetojë duke qenë i pajisur me virtytet më të mira të popullit, me edukatën më të lartë që i jep Partia. Partia ka vënë në dispozicion të njerëzve mësimin dhe diturinë, që ata të bëhen të aftë për të kryer gjatë gjithë jetës detyrat e mëdha revolucionare në shërbim të popullit e të atdheut. Njerëzit tanë po përvetësojnë shkencën, me qëllim që të ndihmojnë për lulëzimin e atdheut. Kështu Shqipëria do të bëhet më e fortë dhe e paprekshme nga armiqtë, socializmi nuk do të ketë mortje kurrë dhe do t'i afrohem më tepër komunizmit, shoqërisë pa klasa, ku njeriu arrin një shkallë

zhvillimi kulturor dhe mirëqenieje materiale e shpirtërore shumë të lartë.

Këtij objektiv, natyrisht, do t'ia arrijë doemos Partia jonë, pse ajo ka forca të mëdha, asaj dita me ditë, viti me vit dhe pas dhjetëra dekadash do t'i vijë kurdoherë gjak i ri me forca të shumëfishuara nga populli, vazhdimisht në përtëritje. Këto vepra që ndërtohen në kohën tonë, brezave që do të vijnë më pas do t'u duken të vogla, por, megjithatë, ata do të thonë me mirënjohje: stërgjyshërit tanë kanë vënë gurin e parë të kësaj veprë madhështore, në themelin e së cilës janë djersa dhe gjaku i kulluar i popullit, i burrave dhe i grave të Shqipërisë. Puna e Partisë gjatë këtyre dekadave të para do të jetë një frymëzim i madh dhe i vazhdueshëm për brezat e ardhshëm, pse vija revolucionare e Partisë për zhvillimin e gjithanshëm është vënë në jetë me përpjekje të vrullshme, me duft dhe me luftë të ashpër kundër vështirësive dhe kundërshtarëve që janë munduar dhe do të mundohen të futin gurë në rrotat e zhvillimit të historisë sonë.

Në këtë zhvillim që kemi arritur, gratë e Shqipërisë kanë qëndruar krahu për krahu me burrat, ato e meritojnë plotësisht respektin e madh që kanë Partia dhe populli për to. Në jetë është vërtetuar mësimi i Partisë se pa pjesëmarrjen e gjerë dhe aktive të grave në tërë sferat e jetës, nuk mund të ndërtohet socializmi. Pa gratë, jo vetëm nga pikëpamja biologjike, por edhe nga ajo shoqërore, nuk mund të ketë jetë. Pa gra revolucionare dhe punëtore, të zgjuara e të pajisura me njohuri shkencore, me dituri e me praktikë të pasur, në asnjë mënyrë nuk mund të rriten breza revolucionarësh,

nuk mund të ketë socializëm, nuk mund të ketë parti marksiste-leniniste. Një parti që nuk e ka të qartë që duhet të ndjekë me gruan dhe nuk e shikon këtë anë jetike të çështjes, siç shikon dhe anët e tjera, nuk është marksiste-leniniste. Partia marksiste-leniniste duhet jo vetëm të dijë t'i çmojë gratë, po në të njëjtën kohë ajo duhet t'i nxitë ato drejt progresit për të kompensuar atë boshllëk të madh që është krijuar gjatë shekujve në trajtimin e tyre. Ky boshllëk rëndon edhe mbi burrat, edhe mbi gratë. Gjatë 32 vjetëve të ekzistencës së Partisë ne kemi arritur rezultate të mëdha, por me gjithë punën e madhe që është bërë, jemi akoma prapa në zhvillimin e gjithanshëm të gruas.

Ne njohim se për sa i përket barazisë së plotë midis burrit e gruas ka diferencime. Po të mos e njohim këtë realitet, po të mos i luftojmë këto diferencime, po të mos luftojmë mbeturinat te burrat dhe te gratë, nuk ka përparim, nuk mund të ecet përpara. Të gjitha këto shpërpjesëtime midis barazisë efektive të burrave dhe grave, si dhe të këqijat që rrjedhin së këtejmi, janë shpjeguar, do të shpjegohen e do të kuptohen edhe më mirë nga Partia dhe nga gjithë populli. Vetëm kështu do të ecë puna përpara.

Gruaja shqiptare po përparon kudo dhe për çdo gjë. Në radhë të parë, në industri e bujqësi, që janë bazat e ekonomisë sonë socialiste, gratë po punojnë me shumicë; ato janë të zgjuara dhe të talentuara, prandaj disa prej tyre kanë marrë në dorë drejtimin e fabrikave, të kooperativave etj. Ka burra, të cilët për arsye që dihen, se janë thënë shpeshherë, janë më të ngritur se gratë, por disa prej tyre, për shkak të mbeturinave

të së kaluarës, bëhen pengesë për emancipimin e plotë të grave. Kundër këtyre shfaqjeve që pengojnë përparimin e gruas ne do të luftojmë dhe do të fitojmë së toku. Kundër pengesave në rrugën e përparimit të gruas do të veprojmë çdo ditë, gjersa t'i zhdukim përfundimisht.

Në sajë të punës së bërë, gruaja te ne ka arritur suksese të mëdha në të gjithë sektorët e jetës, ajo ka bërë hapa përpara jo vetëm në prodhim, por edhe në fushën e kulturës, të letërsisë dhe të arteve. Në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës gratë u shquan për interpretime dhe ekzekutime shumë të bukura të këngës dhe të valles popullore. U lumtë grave! Përpara nënat e motrat tona të mira nuk i kishin mundësitë që keni sot ju, bijat e tyre. Ne, njerëzit me moshë mbi 60 vjeç, i kemi ruajtur në kujtesën tonë vuajtjet e nënave dhe të motrave tona. Ato vuanin se ashtu kanë qenë koha dhe regjimet. Sot ju mund t'i lexoni në libra këto ngjarje të së shkuarës, megjithëse ka raste që edhe tash mbi gratë rëndojnë akoma pasojat e mbeturinave të theksuara të kohës që s'kthehet më.

Kur shikon tani që gruaja dhe vajza del në skenë dhe këndon e kërcen bashkë me burrat, të cilët i ka shokë pune dhe shkolle, të bëhet zemra mal. Kjo është një fitore e mrekullueshme. Mëma ime më thoshte: «Derisa u plaka, o Enver, nuk kam kaluar nga sheshi i pazarit në Gjirokastrë!». Ju e patë pazarin në Gjirokastrë, por, po të kalonte nëna ime përmes tij, këtu e 60 e ca vjet përpara, njerëzit do t'i kallëzonin babait për «fajin e madh» të gruas dhe ai i mërëzitur do t'i thoshte asaj: «Ç'që ai turp që bëre, që kalove nga mesi i pazarit», megjithëse

ajo do të dilte e mbuluar me çarçaf të bardhë. Ç'ndryshime janë bërë! Tani vajzat dhe gratë vijnë nga malësitë e Mirditës e të Dibrës në Gjirokastrë dhe vallëzojnë si motrat me vëllezërit e tyre. Ja ç'bën përparimi, ja ç'bën kuptimi i drejtë politik dhe teorik i vijës së Partisë i konkretizuar në praktikë.

Gratë tona, krah për krah me burrat, po i çojnë përpara prodhimin, shkencën. Me pjesëmarrjen aktive të tyre u zhvilluan më tej kultura, folklori dhe muzika jonë. Nuk është parë ndonjëherë në vendin tonë një përparim si ky. Festivali tjetër sigurisht do të jetë më i mirë. Në këtë festival që u bë tani në Gjirokastrë morën pjesë njerëzit më të talentuar e më të zgjedhur të lëvizjes së madhe amatore, prandaj edhe përshtypjet që lanë ata ishin nga më të mirat. Por, kur këndonin pjesëmarrësit e festivalit, bashkë me ta këndonin edhe mijëra të tjerë në fshatra e qytete, nëpër shtëpitë e vatrave të kulturës, nëpër ara e sheshe.

Si në çdo drejtim, edhe për këtë festival, ju gratë keni meritat tuaja të veçanta e të mëdha, sidomos në ruajtjen e karakteristikave të bukura që kanë vallet e grave të krahinave të ndryshme shqiptare. Në festival u demonstruan një mori vallesh popullore me një dinamizëm të habitshëm, me një ritëm të bukur dhe me një kuptim të lartë, që tregon zhvillimin e përparimin e grave, ndjenjën e tyre të lirisë, jo të skllavërisë së dikurshme. Sot gratë shqiptare nuk rrinë më kokulura, por edhe në të kaluarën, kur pesha e zakoneve, e kanuneve dhe e paragjyqimeve fetare rëndonte mbi to, kanë ruajtur krenarinë e tyre, gjë që pasqyrohet edhe në vallet e festivalit.

Pjesëmarrëset e **festivalit** ishin të gjitha amatore, por kënduan **shumë mirë** dhe me shumë mjeshtëri. Ato kishin zë **shumë** të bukur, kënduan në mënyrë preklëse dhe entuziazmuese, por, mbi të gjitha, merita më e **madhe** e grave ishin qëndisimat e bukura të veshjeve. Ka pasur edhe burra që kanë punuar qëndisima, si bie **fjala** në Shkodër, por përgjithësisht qëndisimat janë vepër e grave. **Qëndisima** është një art i **veçantë**, shumë i **hollë** dhe i bukur, që kërkon talent, zgjuarsia dhe durim. **Puna** me qëndisimat mund të barazohet me atë të piktorëve të mëdhenj. Ne kemi qenë dhe jemi modestë, por në qoftë se bota **lavdërohet** me të drejtë për **tablotë** e shquara të **piktorëve** të famshëm dhe për të tjera sende që kanë trashëguar nga e kaluara, ne duhet të krenohemi për ornamentet popullore, për qëndisimat tona që **rrallë** e tek mund **t'i** gjesh. Nëpër **anët** e **librave** të vjetër arabë, persianë, si kuranë e të tjerë, që kam parë unë, **bënin** qëndisima me fije **floriri** dhe me bojë të zezë ose mereqep, siç i thoshin atëherë. Por qëndisimat tona **janë jashtëzakonisht** të bukura e të habitshme, të punuara me një **kulturë** të **lartë** nga duart e shkathëta të grave dhe të vajzave shqiptare. Ato i qëndisin dy anët e **jelëve** aq bukur dhe aq simetrike, saqë, megjithëse janë të **komplikuara**, po **t'i** matësh me milimetra, asgjë nuk del e gabuar.

Partia jonë **flet** me respekt të madh për talentin e shquar të grave. Gruaja shqiptare, që nuk ia ka bërë dhe nuk ia bën kurrë fjalën dy Partisë, është hedhur në luftë për ndërtimin e **socializmit**, prandaj është e nderuar në shoqëri. Kështu do të **jetë** ajo edhe **në** të ardhmen.

Ju ftoj, të dashura shoqe, ta ngremë këtë doli për Partinë tonë të madhe e të lavdishme dhe për gruan heroike shqiptare.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për gruan» (Përmbledhje veprash), Tiranë 1986, f. 557*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Për gruan» (Përmbledhje veprash), Tiranë 1986, f. 557*